



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE  
BORDI**

---

**VENDIM**

**Nr. 19, datë 28.04.2015**

**PËR**

**MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR AKTIVET NË MBULIM TË PROVIGJONEVE  
TEKNIKE DHE LLOJET E INVESTIMEVE TË LEJUARA TË KËTYRE AKTIVEVE”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 2, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, si dhe të nenit 97, pika 5 dhe pika 1, germa g), të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e Rregullores “Për aktivet në mbulim të provigjoneve teknike dhe llojet e investimeve të lejuara të këtyre aktiveve”, sipas tekstit bashkëlidhur.
2. Ngarkohen departamentet përkatëse për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**  
**Pajtim MELANI**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV**  
**Enkeleda SHEHI**